



Pranuar / Dorezuar Prijeto/Prodato Received/Delivery	25-01-2023	3	viti god year
Organ / Njësia Org. / Jedinica Org. / Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot. No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHUK	879/2023		1/3



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.28/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, duke vepruar sipas ankesës me numër A.nr.28/2023 të datës 06.01.2023 të parashtruar nga ankuesja [redacted] nga Gjakova, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 24.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.28/2022 të datës 06.01.2023, të parashtruar nga ankuesja [redacted]

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted], më datë 04.01.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 93/2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.1235/2022 të datës 06.12.2022 të Inspektoratit të Punës në Gjakovë, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtas materiale si dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës administrative.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë së ankuesja ka aplikuar në Konkursin e shpallur me datë 14.09.2022 nga Kompania Rajonale e Ujit "Gjakova" për pozitën e punës "Inxhinier i Ujërave të Ndotura dhe Industriale, duke u shpallur edhe si kandidatë fituese për këtë pozitë. Inspektorati i Punës në Gjakovë, duke vepruar sipas ankesës së kandidatës [redacted], me Vendimin më numër 1235/2022 të datës 06.12.2022 ka anuluar procedurën e Konkursit të datës 14.09.2022 lidhur me pozitën e punës Inxhinier i Ujërave të Ndotura dhe Industriale.



Ankuesja kundër vendimit me numër 1235/2022 të datës 06.12.202 të Inspektorati i Punës në Gjakovë, parashtron ankesë më datë 06.01.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtas materiale si dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës administrative.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin në mënyrë takastive janë përcaktuar kategoritë e zyrtareve të përjashtuara nga Ligji për Zyrtarët Publikë, rrjedhimisht me paragrafin 5 të nenit 3 është përcaktuar se: "5. Ky ligji, gjithashtu, nuk zbatohet për personelin e ndërmarrjeve publike, në pronësi të Qeverisë apo të një komune, për të cilat marrëdhënia e punës rregullohet me legjislacionin e punës. Ndërlidhur me këtë, Kolegji duke ju referuar shtojcës 1 të Ligjit Nr. 3/1-087 për Ndërmarrjet Publike, ka konstatuar së Kompania Rajonale e Ujit " Gjakova", është ndërmarrje publike e kategorizuar si Kompani Rajonale e Ujësjetës.

Në kuptim të caktimit të kompetencës lëndore lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit ka analizuar edhe Aktgjykimin në rastin nr. K027/21 të datës 16.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, ku me pikën 104 të këtij aktgjykim është konstatuar se: "Gjykata verën se Ligji i Punës, Ligji për Inspektoratin e Punës, Ligji për Siguri dhe Mbrojtje në punë, mandatojnë Inspektoratin e Punës për mbikëqyrjen e zbatimit të këtyre ligjeve në pajtim me fushëveprimin dhe funksionet e përcaktuara në nenin 1 dhe 2 të Ligjit nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës. Por, as në dispozitat e këtij ligji, ligjeve të tjera dhe as nga gjuha e nenit 94 të Ligjit të Punës, nuk mund të kuptohet e as të nënkuptohet që një organ inspektues mund të përvetësojë funksione gjyqësore. Gjuha e normës kushtetuese është e qarte. Funksione gjyqësore mund të ushtrojnë vetëm gjykatat, sipas parimeve të përcaktuara me Kushtetute dhe ligjet përkatëse . Andaj, nisur nga ky vlerësim kushtetues, Kolegji i u referua edhe dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, përkatësisht nenit 78 me të cilin është përcaktuar se: 1. I punësuar i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë të punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura. 2. Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës. 25 3. Vendimi nga paragrafi 2. i këtij neni, i dorëzohet të punësuarit në formë të shkruar brenda afatit prej tetë (8) ditësh" , si dhe nenin 79 më të cilin thuhet se: " Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente, rrjedhimisht, Kolegji konstaton së të punësuarit në ndërmarrje publike fillimisht duhet të ankohen tek punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Në vështrim të dispozitave të nenit 101 paragrafi 2 të Kushtetues së Kosovës si dhe nenit 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, e mbi këtë bazë rrjedhë së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës nuk është kompetent që të shqyrtoj ankesat lidhur me kontestet e marrëdhënies së punës të të punësuarve apo kandidatëve për punësim në ndërmarrjet publike, përkatësisht Këshilli nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankueses



Andaj, marr parasysh konstatimin si me lartë së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.28/2023 të datës 06.01.2023 dhe meqenëse nga shkresat e lëndës vërehet se ankuesja ka shfrytëzuar mjetet juridike në procedurë administrative pranë organit publik, e njëjta udhëzohet për inicim të kontestit gjyqësor në gjykatën kompetente në pajtim me dispozitat e Ligjit të Punës, pasi që lënda nuk mund të bartët të gjykata kompetente ngase në këtë fazë mungon padia si kusht kryesor për fillimin e një procesi gjyqësor.

Theksuar si më sipër, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.28/2023

**Avdyl BEKTESHI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Ardita Haxhnikaj-DEMI**

Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankueses
- Kompanisë Rajonale të Ujësjetësimit në Gjakovë;
- Inspektoratit të Punës në Prishtinë,
- Arkivit të KPMSHCK- së;

